



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 8

Tiranë – E hënë, 27 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 1788, datë 20.3.2017	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës për “Ekspert lokal individual për IT që do të ndihmojë MMSR-në në zbatimin dhe përdorimin efektiv të sistemit të NE dhe MIS e DA”..... 3



**KËRKESË
E MINISTRISË SË MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
Nr. 1788, datë 20.3.2017**

**PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË
ASISTENCËS SOCIALE (SAMP)**

16 mars 2017

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI
SHËRBIME KONSULENCE
PËR**

**“Ekspert lokal individual për IT që do të
ndihmojë MMSR-në në zbatimin dhe
përdorimin efektiv të sistemit të NE dhe
MIS e DA”**

Numër reference: SAMP/CS/IC/16-2016

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale -
(SAMP)*

Hua no.: 8141- AL

Nr. i identifikimit të Projektit. P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës lokale (“Shërbim”) përfshin **“Ekspert lokal individual për IT që do të ndihmojë MMSR-në në zbatimin dhe përdorimin efektiv të sistemit të NE dhe MIS e DA”**.

Qëllimi kryesor i këtij shërbimi është të asistojë me mbështetje teknike Drejtorinë e Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara, në MMSR, në zbatimin e sistemit e Menaxhimit të Informacionit për programet e NE dhe PAK dhe të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve të personelit të përfshirë në zbatimin e shtrirjes së reformës së NE-së në nivel kombëtar dhe reformës së PAK në zonat pilote.

Konsulencia do të kryhet nga një ekspert lokal që zotëron kualifikimet minimale si më poshtë vijon:

- Diplomë master është e preferueshme. Diplomë të arsimit të lartë/ universitare në informatikë, telekomunikacion apo shkenca kompjuterike është një kërkesë e detyrueshme;

- Së paku 5 vjet përvojë pune profesionale në fusha të ngjashme, duke përfshirë përvojën në menaxhimin e sistemeve të informacionit të aplikuara në subjekte private dhe publike;

- Eksperiencë/ i/e familjarizuar me sistemet e informacionit dhe ato të menaxhimit të bazave të të dhënave;

- Njohuri të mira të politikave të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, proceseve dhe procedurave përkatëse, është një përparësi;

- Përvoja me organizata ndërkombëtare dhe/ose agjenci donatore do të jetë një përparësi;

- Aftësi të forta analitike, komunikimi, shkrimi dhe aftësi të raportimit;

- Aftësi të forta kompjuterike (*Windows, MS Office, Internet Explorer*);

- Rrjedhshmëri në anglisht, në të shkruar dhe të folur;

- Aftësi të shkëlqyera të punës në ekupe me staf profesional.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) fton të gjithë konsulentët individualë (“Konsulentë”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e shortlistimit, janë:

1. Arsimimi i përshtatshëm dhe kualifikimet e përgjithshme	30 pikë
2. Eksperienca profesionale e punës në fusha të ngjashme	30 pikë
3. Përshtatshmëria me projektin	40 pikë
TOTALI	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së dhe grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore* (“Udhëzuesi i konsulencës”) - versioni i janarit të 2011-s.

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është **konsulencë individuale (IC)**, në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimet e Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore* (edicioni i janarit të vitit 2011-s).



Ky është një shërbim me kohë të plotë dhe eksperti do të punësohet në bazë të një kontrate time-base. Ky shërbim pritet të fillojë në prill dhe do të përfundojë brenda 4.5 muajsh.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **31 mars 2017**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
“Rruga e Kavajës”, AL-1001, Tiranë,
ALBANIA

Në vëmendje të: znj. Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017